
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Leos construction SHPK**

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I LEOS CONSTRUCTION SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Leos construction SHPK

KREU I

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

- 1.1** Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Leos construction” SHPK**.
(mëposhtë e quajtur **“Shoqëria”**).

Emri tregëtar Leos Construction.

NENI 2

SELIA

- 2.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Dhimiter Kamarda, Nr.100-101, Tiranë, Shqipëri.
Mob 0692028999, email f.radaci@cwpa.al.

- 2.2** Ortaket e Shoqërisë mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 3.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1** Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:
- Ne fushën e ndërtimit, punime ndërtimi, projekte, prodhim materiale ndërtimi,



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I LEOS CONSTRUCTION SHPK

mbikqyrje, kolaudim, etj.

- Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore shumë katëshe.
- Rikonstruksione.
- Ndërtim rruge kategoria IV dhe V. Ndërtim rruge kategoria III-II-I.
- Punime te mirëmbajtjes dhe sinalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore.
- Ndërtim, ujesjelles-kanalizime, kanale, impiante vaditese. Përforcime themeli e punime nëntokesore. Izolime mbi dhe nëntokesore nga ujrat. Themele te vecanta.
- Ndërtim rrugësh dhe urash si dhe ndërtime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim.
- Ndërtim digash, galeri, tunele. Ndërtim vepra kullimi, ujitje, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe siteme hidraulike, punime dhe sitemime elektrike.
- Ndërtim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte. Tregtimi me shumice e pakice, import-eksport i mallrave dhe materiale te ndryshme industriale, materiale elektrike te tensionit te ulet dhe te larte, makineri e pajisje te ndryshme, pajisje ndertimi, pajisje elektrike edhe elektronike, pajisje hidraulike, hidrosanitare, materiale ndërtimi, mallra të të gjitha llojeve.
- Prodhim materiale inerte. Prodhim elemente betoni e beton arme, gure dekorative.
- Shoqëri administrimi për administrimin dhe mirëmbajtjen e pronës së përbashket në godinat e banimit, administrimi i bashkëpronësise në ndërtesa.
- Vlerësimi i pasurive të paluajtshme të çdo lloji: truall, ndërtesa civile dhe industriale, toka bujqësore, ara, pyje, kullota, livadhe etj.
- Hartimin e raporteve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme për bankat e nivelit te dytë, fonde investimi, persona fizik dhe juridik.
- Konsulencë në fushën e ndërtimit, hartimin e kontratave. Akt-marrëveshjeve midis investitorit dhe palës pronare si dhe çdo lloj akti tjetër publik.
- Grumbullim dhe transportim mbetje jo të rrezikshme. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme.

4.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

4.3 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj.



KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1** Kapitali i Shoqërisë do të jetë prej 100.000(njëqindmije)Lekë. Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërise është ne përputhje me kontributet e mëposhtëme:
- Ortak themelues **Fran Preng Radaçi** shtetas Shqiptar, lindur me 21/10/1966, identifikuar me kartën e ID 034308129 dhe numër personal **G61021089V**, banues në Rr.Dhimiter Kamarda, Nr.100-101, Tiranë, Shqipëri.
Mob 0692028999 , email f.radaci@cwpl.al .
Zotëron **1(një)** kuote me vlerë të përgjithshme **100%** (njëqind përqind) të kapitalit themeltar.

NENI 6

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETET

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund tu transferohen të tretëve në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 6.2** Ortakët e shoqërisë kane te drejtën e parablerjes.
- 6.3** Ne rast zmadhimi apo zvoglimi te kapitalit themeltar te Shoqerise, ortaket do te kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvoglimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesmarrjen që zotëron secili prej tyre në kapitalin e shoqërisë.

NENI 7

BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.



KREU III

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 8

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 8.1** Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarres i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas Akt Themelimit dhe Statutit dhe/ose cdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë, dhe veçanërisht mbi vijueset:
- (i) ndryshimin e këtij Statuti,
 - (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë,
 - (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë,
 - (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar,
 - (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar,
 - (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë,
 - (vii) emërimin e likuidatorit(ëve)
 - (viii) percaktimin e pages për administratorin/et, likujduesin/et, dhe të ekspertit/et kontabel të autorizuar të pavarur të shoqërisë.
 - (ix) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon asamblesë së përgjithshme.
- 8.2** Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

NENI 9

FINANCIMI I SHOQËRISË

- 9.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 9.2** Ortakët e shoqërisë do të kontribuojë në shoqëri me para ose në natyrë.
- 9.3** Financimet e mëtejshme të ortakëve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.



KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë ka të drejtë të emërojë, apo pushojnë në çdo kohë Administratorin.
- 10.2** Si Administrator i Shoqërisë emërohet:
- **Fran Preng Radaçi** shtetas Shqiptar, lindur me 21/10/1966, identifikuar me karten e ID 034308129 dhe numer personal **G61021089V**, banues ne Rr.Dhimiter Kamarda, Nr.100-101, Tiranë, Shqipëri.
Mob 0692028999 , email f.radaci@cwpa.al ..
- 10.3** Administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 10.4** Administratori vepron në përputhje me politikat e biznesit të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Asamblese se Përgjithshme të Shoqërisë.
- 10.5** Administratori është përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori mund t'ua delegojë palëve të treta tagrat e lidhura me administrimin e Shoqërisë. Administratori mbetet përgjegjës i drejtpërdrejtë për të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit në lidhje me administrimin e Shoqërisë.



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I LEOS CONSTRUCTION SHPK

- 10.6** Administratori do të veprojë gjatë gjithë kohës në interes të Shoqërisë. Në rast të një konflikti interesi, Administratori do të informojë menjëherë Ortaket e Shoqërisë, dhe nuk do të kryejë asnjë veprim lidhur me çështjen objekt i konfliktit të interesit, deri në pajisjen me udhëzimet përkatëse nga Ortaket e Shoqërisë.

NENI 11

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORËVE

- 11.1** Ortaket e Shoqërisë përcaktojnë shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU V

KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË

VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 12

KONTROLLI KONTABËL

- 12.1** Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaket e Shoqërisë do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 13

VITI FINANCIAR

- 13.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 14

BILANCI VJETOR DHE REZERVAT

- 14.1** Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 14.2** Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventarët, raportet e Administratorit dhe Ekspertit Kontabël miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I LEOS CONSTRUCTION SHPK

Administratori i paraqet Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise për miratim, raportin mbi administrimin e Shoqërisë si dhe pasqyrat financiare vjetore.

- 14.3** Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 14.4** Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 15
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 15.1** Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 16
NJOFTIMET

- 16.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 16.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 16.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.



KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 17

LIGJI I ZBATUESHEM

- 17.1** Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e këtij Akti Themelimi, Statuti dhe legjislacionit shqiptar. Për të gjitha ato çështjet që nuk janë parashikuar në këtë dokument, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar mbi shoqëritë tregtare.

NENI 18

ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

- 18.1** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve të saj, ose ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të tyre, dhe/ose Shoqërisë, lidhur me interpretimin dhe / ose zbatimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve të interesuar. Në rast se nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 19

GJUHA

- 19.1** Ky Akt Themelimi dhe Statut përpilohet në 5 (pese) kopje në shqip,

Nenshkruar me datë 09/01/2025.

ORTAKU I VETEM

Fran Radaçi

